

**“CREDINS INVEST” SH.A.
SHOQËRI ADMINISTRUESE E FONDEVE TE PENSIONIT DHE
SIPERMARRJEVE TE INVESTIMEVE KOLEKTIVE**

**PASQYRAT FINANCIARE
31 Dhjetor 2018**

Raportet financiare për vitin 2018

TABELA E PERMBAJTJES

1 Pasqyrat financiare të Shoqërisë

1. Pasqyra e Bilancit
2. Pasqyra e Fitim / Humbjeve
3. Pasqyra e Fluksit të Parave
4. Pasqyra e ndryshimit të kapitalit
5. Shënime

1 Pasqyrat financiare të Shoqërisë

Informacioni	Përshkrimi, vlera
Kodi i shoqërisë administruese	K52311009R
Numri i regjistrimit në QKR	CN-741398-06-16
Numri për raportimin	3
Adresa	Njesia bashkiake Nr. 5, Rr. “Nikolla Tupe”, Nr. 1, Kati 3, Tiranë
Telefon dhe fax	+355 4 53 51 030;
Email:	acitozi@credinsinvest.com
Faqe ëeb	www.credinsinvest.com
Data e licensimit	30 Maj 2016
Data e miratimit të Fondit te Pensionit	13 Dhjetor 2011
Data e miratimit të Fondit të Investimit	30 Maj 2016
Emri dhe mbiemri i Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit Administrativ	Vjosa Bodo - Kryetare Eugen Nuri-anëtar Estela Koçi-anëtare Admir Ramadani-anëtar Egi Santo-anëtar
Pesë aksionerët më të mëdhenj (emri,mbiemri, adresa, ose emri i shoqërisë dhe adresa e zytare, përqindja e aksioneve në pronësi)	
Emri i shoqërisë	CREDINS BANK
Adresa zyrtare	Rr.Vaso Pasha, Nr.8, Tiranë
Perqindja e aksioneve	76%
Emri i shoqërisë	SiCRED Shoqëri Sigurimi Jete
Adresa zyrtare	Nj.bashk. 5, Rr. Brigada 8, Vila 3/1
Perqindja e aksioneve	24%
Shoqëria audituese	Grant Thornton sh.p.k.Tiranë
Numrat e llogarisë :	
Nr. e llogarisë të Shoqërisë Administruese të Fondeve të Pensionit dhe Siper marrjeve te Investimeve Kolektive	
Banka Credins në lekë	318654
Banka Credins në euro	318656
Tirana Bank	0111-313969-100;
ABI Bank	AL07 2101 1012 0000 0000 0166 7186
Nr e llogarisë të Fondit Vullnetar “Credins Pension”:	
Tirana Bank	0110-313-979-100;0111-313979-100; 0111-313979-101
Nr e llogarisë të Fondit te Investimeve “CREDINS PREMIUM”:	
ABI Bank	AL98 2101 1012 0000 0000 0166 7197

1. Pasqyra e Bilancit

Emri i shoqërisë administruese: **“Credins Invest” sh.a., Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Siper marrjeve të Investimeve Kolektive**

Kodi i shoqërisë: **K52311009R**

Për datën: 31.12.2018

AKTIVI	Shënime	31/12/2018	31/12/2017
A. Aktive afatgjata (I+II+III+IV)		27,353,906	24,933,553
I. Aktive afatgjata materiale (1+2)		6,689,544	3,047,739
1. Toka dhe Ndërtesa			
2. Të tjera aktive afatgjata materiale	4	6,689,544	3,047,739
II. Aktive jo-materiale	5	3,664,362	4,885,814
III. Aktive financiare(1+2+3+4)		17,000,000	17,000,000
1. Depozita bankare	6	17,000,000	17,000,000
2. Të vlefshme për shitje		-	-
3. Të mbajtura deri në maturim			
4. Të tjera aktive financiare afatgjata			
IV. Investimet që kontabilizohen duke përdorur metodën e kapitalit neto			
B. Aktivi tatimor i shtyrë			
C. Aktive afatshkurtra (I+II+III+IV+V+VI+VII)		16,017,613	13,634,538
I. Pajisje në magazinë, inventar i imët dhe pajisje të tjera			
II. Llogari të arkëtueshme tregtare (1+2+3+4)		3,081,505	1,626,389
1. Llogari të arkëtueshme nga fondet e pensioneve dhe investimeve	7	3,071,505	1,616,389
2. Llogari të arkëtueshme nga shumat e paguara tepër, bazuar në fitim.			
3. Llogari të arkëtueshme nga shteti dhe institucione të tjera		10,000	10,000
4. Të tjera llogari të arkëtueshme nga personeli			
III. Aktive financiare (1+2)			5,000,000
1. Depozita bankare	8	0	5,000,000
2. Të tjera aktive dhe llogari të arkëtueshme afatshkurtër			
IV. Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare (1+2)		12,170,218	6,341,181
1. Llogari rrjedhëse dhe ekuivalentë të mjeteve monetare në bankë	9	12,170,218	6,341,181
2. Mjete monetare në arkë			
V. Shpenzime të parapaguara	10	356,164	263,242
VI. Te ardhura të përllogaritura nga depozitat	11	409,726	403,726
VII. Parapagime per softëare			
D.Totali i Aktiveve(A+B+C)		43,371,519	38,568,091

PASIVI	Shënime	31/12/2018	31/12/2017
A. Kapitali (I+II+III+IV+V+VI)		40,332,386	36,682,921
I. Kapitali i nënshkuar	12	95,822,394	87,822,394
I. a Kapitali i nënshkuar, paregjistruar	12	-	8,000,000
II. Rezerva të kapitalit	12	10,000,000	10,000,000
III. Rezerva e rivlersimit			
IV. Rezerva të tjera			
V. Fitime / humbje të mbartura		-69,139,473	-63,287,852
VI. Fitimi /humbja neto për periudhën		3,649,465	-5,851,621
B. Detyrime afatgjata (I+II+III)			
I. Detyrime ndaj fondeve të pensionit			
II. Detyrime të lidhura me hua dhe kredi			
III. Detyrime të tjera afatgjata			
C. Detyrim tatimor i shtyrë			
D. Provigjone për shpenzime dhe rreziqe			
E. Detyrime afatshkurtra (I+II+III+IV+V)		3,039,133	1,885,170
I. Detyrime ndaj fondeve të pensionit			
II. Detyrime të lidhura me hua dhe kredi			
III. Llogari të pagueshme tregtare dhe llogari të tjera të pagueshme	13	3,039,133	1,885,170
IV. Shpenzime të shtyra			
V. Të ardhura të marra në avancë			
F. Totali i pasivit (A+B+C+D+E)		43,371,519	38,568,091

2. Pasqyra e Fitim / Humbjeve

Emri i shoqërisë administruese: **“Credins Invest” sh.a., Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Siper marrjeve të Investimeve Kolektive**

Kodi i shoqërisë: **K52311009R**

Për datën: 31/12/20188

		31/12/2018	31/12/2017
I.Të ardhura nga administrimi i fondit (1+2+3)		28,898,889	14,061,599
1.a Tarifa të administrimit të Fondit të Pensionit Vullnetar Credins Pension	14	14,230,082	8,711,196
1.b Tarifa të administrimit të Fondit të Investimit Credins Premium	14	13,622,946	4,866,762
2.Tarifa të largimit nga Fondi I Pensionit Vullnetar Credins Pension	15	1,040,944	483,641
3.Tarifa të tjera		4,917	
II. Shpenzime nga administrimi i fondit (1+2+3+4)		3,356,253	1,904,095
1.a Shpenzime të transaksioneve dhe tarife depozitari për Fondin e Pensionit		987,290	621,032
1.b Shpenzime të transaksioneve dhe tarife depozitari për Fondin e Investimit		2,116,899	977,329
2. Shpenzime të marketingut			
3.a Shpenzime të shitjes me agjent FP			
3. b Shpenzime të shitjes me agjent FI		216,492	112,750
4. Shpenzime të tjera të administrimit të fondit të pensionit		35,572	192,984
III. Fitim / Humbja nga administrimi i fondit të pensionit (+/-) (I - II)		25,542,637	12,157,504
IV. Të ardhura të tjera	16	4,384,515	3,558,639
V. Shpenzime të veprimtarisë së shoqërisë administruese (1+2+3+4+5+6)		26,586,942	22,750,979
1. Shpenzime për materiale			
2. Shpenzime për personelin	17	18,849,325	15,461,981
3. Amortizim i aktiveve materiale/jomateriale afatgjata	4,5	2,005,600	2,452,944
4. Rregullim i vlerës së aktiveve afashkurtra			
5. Provigjone për shpenzime dhe rreziqe			
6. Shpenzime të tjera të veprimtarisë	18	5,732,017	4,836,054
VI. Të ardhura financiare	19	928,881	1,197,510
VII. Shpenzime financiare		- 24,397	14,295
VIII. Fitim / Humbja para tatimit (III+IV-V+VI-VII)		4,293,488	- 5,851,621
IX. Tatimi mbi fitimin		644,023	
X. Fitim / Humbja neto për periudhën (VIII-IX)		3,649,465	- 5,851,621

3. Pasqyra e Fluksit të Parave

Emri i shoqërisë administruese: **“Credins Invest” sh.a., Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipermarrjeve të Investimeve Kolektive**

Kodi i shoqërisë: **K52311009R**

Për datën: 31/12/2018

	31/12/2018	31/12/2017
a. Arkëtime nga veprimtaria shfrytëzuese	33,511,831	11,751,134
b. Pagesa për veprimtarinë shfrytëzuese	27,641,355	22,836,726
c. Flukse monetare neto nga veprimtaria shfrytëzuese (a - b)	5,870,476	-11,085,592
d. Arkëtime nga veprimtaria investuese		26,575,327
e. Pagesa për veprimtarinë investuese	41,439	23,475,900
f. Flukse monetare neto nga veprimtaria investuese (d - e)	-41,439	3,099,427
g. Arkëtime nga veprimtaria financuese		8,000,000
h. Pagesa për veprimtarinë financuese		
i. Fluksi monetar neto nga veprimtaria financuese (g - h)	-	8,000,000
j. Rritja/rënia neto në mjetet monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare(c+f+i)	5,829,037	13,835
k. Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare në fillim të periudhës kontabël	6,341,181	6,327,346
l. Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare në fund të periudhës kontabël (j+k)	12,170,218	6,341,181

4. Pasqyra e ndryshimit të kapitalit

Emri i shoqërisë administruese: **“Credins Invest” sh.a., Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipermarrjeve të Investimeve Kolektive**

Kodi i shoqërisë:
K52311009R

Për datën: 31/12/2018

	Lek	Lek	Lek	Lek
	31/12/2017	Rritje	Zbritje	31/12/2018
I.Kapitali i nënshkruar	87,822,394	8,000,000		95,822,394
I.a Kapitali i nënshkruar,paregjistruar(<i>shënimi nr.12</i>)	8,000,000		8,000,000	0
II. Rezerva kapitali	10,000,000			10,000,000
III. Rezerva e rivlerësimit	0			0
IV. Rezerva të tjera				
V. Fitime (Humbje) të mbartura	-69,139,473			-69,139,473
VI. Fitimi (Humbja) e periudhës financiare				3,649,465
VII. Pagesat e dividendit				
VIII. Ndryshimet në politikat kontabël dhe korigjime (1+2+3+4+5+6)				
1. Kapitali i nënshkruar				
2. Rezerva kapitali				
3. Rezerva e rivlerësimit				
4. Rezerva të tjera				
5. Fitime (Humbje) të mbartura				
6. Fitimi (humbja) e periudhës financiare				
IX: Shuma që i takon interesit të pakicës				
TOTALI I KAPITALIT	36,682,921	8,000,000	8,000,000	40,332,386

1. Informacione të përgjithshme

“CREDINS INVEST” sh.a., Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive (në vijim “Shoqëria”) është një shoqëri aksionare shqiptare, e regjistruar në Regjistrin Tregtar Shqiptare me Vendim të Gjykatës së Rrethit Tiranë Nr. 34260, më datë 31 Tetor 2005 dhe me seli në Rrugën “Nikolla Tupe”, Nr. 1, Kati 3, Tiranë.

Shoqëria fillimisht u liçencua nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare më datë 23 nëntor 2011, me licencën nr. 3, për të vepruar si Shoqëri Administruese e fondeve të pensionit vullnetar, në mbledhjen dhe investimin e fondeve të pensionit vullnetar dhe kryerjen e pagesave të pensionit sipas Ligji Nr.10197, datë 12 dhjetor 2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”.

Më 30.05.2016, Shoqëria u pajis me liçencën nr. 3, për të administruar asetet e sipërmarrjeve të investimeve kolektive në përputhje me dispozitat e ligjit nr.10198, datë 10.12.2009 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive", krahas veprimtarisë për administrimin e fondeve të pensionit vullnetar. Emri i Shoqërisë u ndryshua në “CREDINS INVEST” sh.a. Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit Vullnetar dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive.

Shoqëria ka në administrim një fond pensioni vullnetar, me emrin “Credins Pension” miratuar më 13 dhjetor 2011 me vendimin Nr. 173 të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare; dhe një fond investimi me emrin “Credins Premium”, miratuar më 30 maj 2016 me vendimin Nr. 85 të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Fondi i Investimit ka filluar veprimtarinë e tij më 1 korrik 2016.

Banka Depozitare e Fondit të Pensionit është Banka e Tiranës sh.a., miratuar me Vendimin Nr.91, datë 18 Korrik 2012, të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Banka Depozitare e Fondit “Credins Premium” është Banka Amerikane e Investimeve sh.a., miratuar me Vendimin Nr.2, datë 31 Janar 2018, të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Shoqëria Administruese dhe Depozitari janë të detyruara të mbajne të ndara aktivet, veprimet dhe regjistrimet e veta, nga aktivet, veprimet, dhe regjistrimet e Fondit të Pensionit Vullnetar, si dhe Fondit të Investimeve, e për këtë arsye edhe raportimet për shoqërinë dhe Fondet paraqiten të ndara.

Më 31 Dhjetor 2018, Shoqëria ka të punësuar 13 punonjës dhe drejtues të lartë (2017:10).

2. Bazat e përgatitjes

a) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

b) Bazat e matjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike përveç aktiveve financiare të vlefshme për shitje, të cilat janë paraqitur me vlerë të drejtë

c) Monedha funksionale dhe raportuese

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në monedhën shqiptare “Lekë”, e cila është monedha funksionale. Përveç rasteve kur është shënuar ndryshe, informacioni financiar është paraqitur në Lekë.

d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga ato të çmuara. Çmuarjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

a) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj këmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit këmben në monedhë funksionale me kursin e këmbimit të asaj date. Fitimi ose humbja nga kurset e këmbimit për zërat monetarë është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhë funksionale në fillim të vitit dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të këmbyer me kursin e këmbimit në fund të vitit.

Aktivitet dhe detyrimet jo-monetare të nominuara në monedhë të huaj të cilat maten me vlerë të drejtë këmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës në të cilën është përcaktuar vlera e drejtë. Zërat jo-monetarë në monedhë të huaj të cilat maten me kosto historike këmben me kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

Kurset e këmbimit zyrtare bankare të zbatuara sipas Bankës së Shqipërisë (Lek kundrejt njësisë së monedhës së huaj) për monedhat kryesore më 31 Dhjetor 2018 dhe 31 Dhjetor 2017 ishin si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2018</u>	<u>31 Dhjetor 2017</u>
EUR	123.42	132.95

b) Plani i Kontributeve të Përcaktuara

Nën planin e kontributeve të përcaktuara, shuma e përfitimeve të ardhshme është përcaktuar nga kontributet e paguara dhe nga interesat e fituara të fondit. Detyrimet janë njohur në fitim apo humbje në periudhën e duhur dhe janë paraqitur interesa të shtuara te fondit të pensionit nga të ardhurat nga investimet.

c) Instrumentat Financiare

SNRF 9 Instrumentet Financiare

Klasifikimi dhe matja e aktiveve financiare

Përveç disa prej llogarive të arkëtueshmeve tregtare, një njësi ekonomike do të matë një aktiv financiar me vlerën e drejtë të tij plus, në rastin e një aktivi financiar jo me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, koston e transaksionit. Instrumentet e borxhit maten më pas me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (VDNFH/FVTPL), koston së amortizuar ose vlerës së drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDNAGJ/FVOCI), në bazë të flukseve monetare kontraktuale dhe modelit të biznesit sipas të cilit mbahen instrumentet e borxhit. Ekziston një opsion me vlerën e drejtë (OVD/FVO) që lejon që aktivet financiare në njohjen fillestare të përcaktohen si vlera e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, nëse eliminon ose redukton ndjeshëm një mospërputhje kontabël. Instrumentet e kapitalit përgjithësisht maten në vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Megjithatë, njësitë ekonomike kanë një opsion të parëvokueshëm, instrument pas instrumenti, për të paraqitur ndryshimet në vlerën e drejtë të instrumentave jo-tregtarë në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse (ATGJ/OCI) pa riklasifikim pasues në fitim ose humbje.

• SNRF 9 Instrumentet Financiare (vazhdim)

Klasifikimi dhe matja e detyrimeve financiare

Për detyrimet financiare të përcaktuara si vlera e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes duke përdorur opsionin me vlerën e drejtë, shumën e ndryshimit në vlerën e drejtë të këtyre detyrimeve financiare që i atribuohet ndryshimeve në rrezikun e kredisë, duhet të paraqitet në të ardhura të tjera përmbledhëse. Pjesa tjetër e ndryshimit në vlerën e drejtë paraqitet në fitim ose humbje, përveç nëse paraqitja në të ardhura të tjera përmbledhëse të ndryshimit të vlerës së drejtë në lidhje me rrezikun e kredisë së pasivit krijon ose zmadhon një mospërputhje kontabël në fitim ose humbje.

Të gjitha SNK 39 Instrumentat Financiarë: Njohja dhe Matja dhe kërkesat për matjen e detyrimeve financiare janë mbartur në SNRF 9, duke përfshirë rregullat e ndarjes së derivateve të përfshirë dhe kriteret për përdorimin e opsionit të vlerës së drejtë.

Zhvlerësim

Kërkesat për zhvlerësim bazohen në një model të humbjes së pritshme së kredisë (ECL) që zëvendëson modelin e humbjeve të SNK 39. Modeli i humbjes së pritshme së kredisë zbatohet për instrumente borxhi të llogaritura me kosto të amortizuara ose në vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse, shumica e angazhimeve të huasë, kontratat e garancisë financiare, aktivet e kontratës sipas SNRF 15 Të hyrat nga Kontratat me Konsumatorët dhe llogaritë e arkëtueshme të qerasë sipas SNK 17 Qerata ose SNRF 16 Qerata.

Subjekteve zakonisht i kërkohet të njohin humbjen e pritshme (ECL) 12 mujore në njohjen fillestare (ose kur është lidhur angazhimi ose garancia) dhe më pas, për sa kohë që nuk ka përkeqësim të konsiderueshëm në rrezikun e kredisë. Megjithatë, nëse ka pasur një rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë në baza individuale ose kolektive, atëherë subjektet duhet të njohin humbjen e pritshme për të gjithë ciklin e jetës. Për llogaritë e arkëtueshmet tregtare, mund të zbatohet një qasje e thjeshtuar ku cikli i jetës së humbjes së pritshme njihen gjithmonë.

Kontabiliteti i instrumentave mbrojtës

Testimi i efektivitetit të mbrojtjes është i mundshëm, pa testin e vijës së ndritshme prej 80% deri në 125% në SNK 39 dhe, duke u varur nga kompleksiteti i mbrojtjes, do të jetë shpesh herë cilësore.

Një përbërës rreziku i një instrumenti financiar ose jo-financiar mund të përcaktohet si element i mbrojtur nëse përbërësi i rrezikut është i identifikueshëm veçmas dhe i matshëm në mënyrë të besueshme. Vlera kohore e një opsioni, çdo element i ardhshëm i një kontrate të ardhshme dhe çdo diferencë bazë në valutë, mund të përjashtohet nga emërtimi i instrumentit mbrojtës dhe mund të kontabilizohet si kosto e mbrojtjes. Më shumë emërtime të grupeve të artikujve si element i mbrojtur janë të mundshëm, duke përfshirë emërtimet e shtresave dhe disa pozicione neto.

Tranzicion

Aplikimi i hershëm është i lejuar për periudhat e raportimit që fillojnë pas dhënies së SNRF 9 më 24 korrik 2014 duke zbatuar të gjitha kërkesat e këtij standardi në të njëjtën kohë. Ndryshe, njësitë ekonomike mund të zgjedhin që në fillim të zbatojnë vetëm kërkesat për paraqitjen e fitimeve dhe humbjeve nga detyrimet financiare të përcaktuara si vlera e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, pa zbatuar kërkesat e tjera në standard.

Ndikim

(a) Klasifikimi dhe matja

Shoqëria nuk pret një ndikim të rëndësishëm në bilancin e saj nga zbatimi i klasifikimit dhe kërkesat e matjes të SNRF 9. Llogaritë e arkëtueshme të tregtisë mbahen për të mbledhur flukse kontraktuale të mjeteve monetare dhe pritet të krijojnë flukse hyrëse që përfaqësojnë vetëm pagesat e principalit dhe të interesit. Kështu, Shoqëria pret që këto të vazhdojnë maten me koston e amortizuar sipas SNRF 9.

Instrumentat financiare konsistojnë në instrumenta borxhi të cilat nuk mbahen për të realizuar fluske kontraktuale por për të realizuar fitime afatshkurtra nga rritja/ulja e normave të interesit. Kështu, Fondi pret që këto të vazhdojnë maten me vlerë të drejtë përmes fitim/humbjes së vitit sipas SNRF 9.

(b) Zhvlerësimi

Fondi klasifikon instrumentat financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes për të cilat nuk kërkohet zhvlerësim sipas SNRF 9.

(c) Kontabiliteti mbrojtës

Fondi nuk ka aplikuar kontabilitetin mbrojtës (Hedging) sipas SNK 39 dhe nuk do të zbatojë kontabilitetin mbrojtës sipas SNRF 9 sepse nuk ka instrumenta mbrojtës.

c) Mjete monetare dhe ekuivalentë me to

Mjete monetare në arkë dhe bankë përfshin gjendjet monetare në arkë, paratë e vendosura në banka dhe investime mjaft likuide afat-shkurtra me maturitet më pak ose deri në tre muaj nga momenti i blerjes.

d) Depozita me afat

Depozitat me afat janë vendosur në pasqyrën e pozicionit financiar në shumën e principalit dhe janë klasifikuar si të tilla ato me maturitet më shumë se tre muaj. Interesi është përlogaritur në baza përlogaritje dhe interesi i arkëtueshëm është pasqyruar në të arkëtueshme të tjera.

e) Aktivitet afatgjata materiale

1) Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale janë paraqitur me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë. Kosto përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejt të ngarkueshme për blerjen e aktivitetit. Kosto e aktiveve të ndërtuara nga vetë Shoqëria përfshin koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore, si dhe ndonjë kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejt me vënien e aktivitetit në vendin dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar nga drejtimi. Blerja e softëare-ve që janë të lidhur ngushtë me funksionalitetet e pajisjes përkatëse janë kapitalizuar si një pjesë e kësaj pajisje. Kur pjesët e një elementi të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si elementë të veçantë (komponentet kryesorë) të aktiveve afatgjata materiale.

2) Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbartur të elementit nëse është e mundshme që përfitime ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij elementi do të rrjedhin në Shoqëri dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave në momentin kur ndodhin.

3) Amortizimi

Amortizimi njihet në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave me metodën e vlerës së mbetur. Aktivitet me qira zhvlerësohen për më të voglën mes periudhës së qirasë dhe jetëgjatësisë së dobishme.

Norma e amortizimit vjetor është si me poshtë:

Pajisje zyre	20 %
Pajisje informatike	25 %

f) Aktive të patrupëzuara

Aktivitet e patrupëzuara njihen me kosto historike, zvogëluar me amortizimin dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë. Shpenzimet e mëvonshme mbi programet kompjuterike kapitalizohen vetëm kur këto shpenzime lidhen me rritjen e përfitimit të ardhshëm ekonomik të këtij aktivi. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në periudhën që ndodhin tek pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve. Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, bazuar në metodën e vlerës së mbetur. Norma e amortizimit vjetor është 25%.

g) Rënia në vlerë e aktiveve jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, përveç aktiveve tatimore të shtyra, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidencë për zhvlerësim. Nëse ka evidencë të tillë atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitet. Humbja nga rënia në vlerë njihet nëse vlera kontabël e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare tejkalon vlerën e rikuperueshme të aktivitet. Njësia gjeneruese e mjeteve monetare është grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron flukse monetare që janë të pavarura nga aktivitet dhe grupet e tjera. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave. Vlera e rikuperueshme e një aktivi, ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është më e madhja ndërmjet vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës së tij në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e vlerësuar të ardhshme të mjeteve monetare janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregjeve për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për aktivitet. Humbjet e mëparshme rishikohen në çdo datë raportimi për të vlerësuar nëse ka evidencë se rënia në vlerë është zbutur, ose nuk ekziston më. Një humbje anulohet nëse ka evidencë se nuk ka zhvlerësim dhe ka patur ndryshim në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga rënia në vlerë anulohet deri në atë masë sa vlera kontabël e aktivitet nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke zbritur zhvlerësimin apo amortizimin dhe sikur të mos ishte njohur më parë ndonjë humbje nga rënia në vlerë.

h) Kapitali aksioner

Kapitali aksionar paraqitet në vlerën e tij nominale. Kapitali aksionar i cili është i nënshkruar për emetim, por që ende nuk është i regjistruar është i paraqitur veçmas në pasqyrën e lëvizjes së kapitalit. Një kontribut i pafinancuar i kapitalit, i cili është i pagueshëm në të ardhmen në një shumë të parapërcaktuar, është klasifikuar si kapital i paregjistruar dhe i papaguar, përveç rasteve kur marrja e kontributit është vlerësuar në mënyrë të arsyeshme.

i) Të ardhurat nga penalitetet

Shoqëria njih të ardhura nga penaliteti në rast tërheqje të parakohëshme nga anëtari i aseteve nga llogaria individuale në fondin e pensionit vullnetar, sipas kërkesave të rregullores nr. 125, datë 07.12.2010 "Për penalitetet e zbatuara në rastin e tërheqjes së parakohëshme nga Fondi i Pensionit Vullnetar". Penaliteti llogaritet mbi vlerën neto të aseteve të kërkuara për t'u tërhequr para kohe, pasi është zbritur tatimi sipas legjislacionit në fuqi në momentin e tërheqjes. Shoqëria nuk njih të ardhura nga penaliteti në rast tërheqje të parakohëshme nga anëtari i aseteve nga llogaria individuale në fondin e investimit.

j) Përfitimet e punonjësve

(i) Kontributet shoqërore të detyrueshme

Shoqëria paguan kontribute shoqërore të detyrueshme për përfitimet e punonjësve që dalin në pension. Kontributet ndaj planit të pensioneve me kontribut të përcaktuar ngarkohen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave kur ato ndodhin. Autoritetet lokale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributësh të përcaktuara për pensione.

(ii) Kontributet shoqërore vullnetare

Shoqëria paguan kontribute shoqërore vullnetare për përfitimet e punonjësve që dalin në pension. Kontributet ndaj planit të pensioneve me kontribut të përcaktuar ngarkohen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave kur ato ndodhin.

k) Tatimi

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital ose në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave të tjera. Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke përdorur normën tatimore në fuqi, ose që konsiderohet si e tillë në datën e mbylljes së pasqyrave financiare dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshme sipas ligjit shqiptar të tatimit.

Tatimi i shtyrë është llogaritur duke përdorur metodën e bilancit, nga diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe bazës tatimore. Shuma e tatimit të shtyrë është llogaritur duke përdorur normën tatimore në fuqi në datën e mbylljes së diferencave, sipas ligjeve në fuqi në datën e raportimit.

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për aq sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit ky aktiv mund të përdoret. Aktiv i tatimor i shtyrë rishikohet në çdo datë raportimi dhe zvogëlohet për aq sa nuk është e mundur të realizohet përfitim fiskal.

Në përcaktimin e vlerës së tatimit aktual dhe të shtyrë Shoqëria merr në konsideratë impaktin e pozicioneve tatimore të pasigurta dhe tatimet dhe interesat shtesë. Shoqëria beson se përlllogaritjet për detyrimet tatimore janë të mjaftueshme për të gjithë vitet e hapura tatimore në bazë të vlerësimit të shumë faktorëve duke përfshirë interpretimet tatimore dhe eksperiencat e mëparshme.

4. Aktive afatgjata materiale, neto

	Pajisje zyre	Pajisje informatike	Totali
Kosto			
Gjendja më 31 Dhjetor 2017	676,180	4,947,498	5,623,678
Shtesa	4,028,190	397,763	4,425,953
Pakësime			
Gjendja më 31 Dhjetor 2018	4,704,370	5,345,261	10,049,631
Zhvlerësimi i akumuluar			
Gjendja më 31 Dhjetor 2017	509,685	2,066,254	2,575,939
Shpenzimi për periudhen	54,997	729,151	784,148
Pakësime			
Gjendja më 31 Dhjetor 2018	564,682	2,795,405	3,360,087
Gjendja më 31 Dhjetor 2017	166,495	2,881,244	3,047,739
Gjendja më 31 Dhjetor 2018	4,139,688	2,549,856	6,689,544

5. Aktive afatgjata jomateriale, neto

	Sisteme elektronike	Totali
<i>Kosto</i>		
Gjendja më 31 Dhjetor 2017	9,467,789	9,467,789
Shtesa		
Pakësime		
Gjendja më 31 Dhjetor 2018	9,467,789	9,467,789
<i>Zhvlerësimi i akumuluar</i>		
Gjendja më 31 Dhjetor 2017	4,581,975	4,581,975
Shpenzimi për periudhen	1,221,452	1,221,452
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2018	5,803,427	5,803,427
Gjendja më 31 Dhjetor 2017	4,885,814	4,885,814
Gjendja më 31 Dhjetor 2018	3,664,362	3,664,362

6. Depozita bankare afat-gjatë

	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Depozite bankare 5 vjeçare (12/07/2017-12/07/2022, 5%, Credins Bank)	17,000,000	17,000,000
	17,000,000	17,000,000

7. Llogari të arkëtueshme nga fondet e pensioneve dhe investimeve

	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Të arkëtueshme nga tarifë administrimi Fondi Pensionit Credins Pension	1,468,022	875,723
Të arkëtueshme nga tarifë administrimi Fondi Investimit Credins Premium	1,603,483	740,666
	3,071,505	1,616,389

8. Depozita bankare me afat

	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Depozite bankare 4 mujore (13/12/2017-13/04/2018; 1%, Credins Bank)	-	5,000,000
	-	5,000,000

9.Llogari rrjedhëse dhe ekuivalente të mjeteve monetare

Llogari rrjedhëse dhe ekuivalentë të mjeteve monetare në bankë	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Depozite bankare 3 mujore 26/10/2018-26/01/2019, 1%, Credins Bank (2017: 27/12/2017-27/03/2018; 1.2%, Credins Bank)	5,000,000	2,000,000
Depozite bankare 2 mujore (2017: 27/12/2017-27/02/2018; 1%; Credins Bank)	-	2,000,000
Depozite bankare 1 mujore (2017: 27/12/2017-27/01/2018; 0.8%; Credins Bank)	-	1,000,000
Llogari në banken Credins në Lek	6,772,102	1,274,024
Llogari në banken Tirana në Lek	66,901	53,557
Llogari në banken ABI në Lek	272,745	9,041
Llogari në Credins Bank në Euro	58,470	4,559
Totali	12,170,218	6,341,181

10.Shpenzime të parapaguara

Shpenzime të parapaguara	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Parapagim sig jete -staf	356,164	263,242
	356,164	263,242

11. Te ardhura të përlogaritura nga depozitat

Te ardhura të përlogaritura nga depozitat	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Depozite 1 vjecare	400,548	400,548
Depozite 1- 3 mujore	9,178	3,178
	409,726	403,726

12. Kapitali

Më 31 Dhjetor 2018, kapitali aksionar i regjistruar është 95,822,394 Lekë, dhe përbëhet nga 233,713.17 aksione me vlerë nominale Lek 410 (2017: Kapitali aksionar 87,822,394 Lekë) . Struktura aksionare bazuar në kapitalin e paguar tërësisht dhe të regjistruar ishte si vijon:

	31 Dhjetor 2018			31 Dhjetor 2017		
	Në %	Numër aksionesh	Në Lek	Në %	Numër aksionesh	Në Lek
CREDINS Bank	76%	177,622.00	72,825,019	76%	162,792.73	66,745,019
SiCRED Sh.a.	24%	56,091.17	22,997,375	24%	51,408.24	21,077,375
	100	233,713.17	95,822,394	100	214,200.97	87,822,394

Kjo strukturë është aprovuar Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare me Vendimin Nr. 145, datë 30.07.2018 dhe u regjistrua në QKR më 20.08.2018.

13.Detyrime të tjera

	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Shërbime profesionale të përlogaritura	489,100	705,820
Detyrime për taksa TVSH dhe sigurime shoqërore , personeli	1,346,301	399,048
Shpenzime të tjera të përlogaritura	56,605	44,402
Shpenzime te perlogaritura per banken depozitare FP	97,868	58,381
Shpenzime te perlogaritura per banken depozitare FI	-	148,591
Shpenzime te perlogaritura tarifa	75,203	89,821
Furnitorë	855,073	325,229
Detyrim ndaj AMF	118,983	113,878
Total	3,039,133	1,885,170

14 . Tarifa të administrimit

Shoqëria mban një tarifë administrimi prej 3% në vit ndaj Fondit të Pensionit dhe 1% në vit ndaj Fondit të Investimit.

Të ardhura nga administrimi i fondit	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Të ardhura nga tarifa administrimit, Fondi Pensionit	14,230,082	8,711,196
Të ardhura nga tarifa administrimit, Fondi Investimit	13,622,946	4,866,762
Total	27,853,028	13,577,958

15.Tarifa të largimit nga fondi

Shoqëria mban penalitet ndaj anëtarëve të fondit të pensionit nëse tërhiqen para kohe.

Tarifa të largimit nga Fondi I Pensionit Vullnetar Credins	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Tarifa te largimit nga tërheqje të parakohëshme	1,040,944	483,641
Total	1,040,944	483,641

16.Të ardhura të tjera

Të ardhura të tjera konsiston në dhurim mjete zyre dhe elektronike për Credins Invest nga Banka Credins, përkatesisht 356,325 lekë pajisje elektronike dhe 4,028,190 lekë pajisje zyre.

17.Shpenzime personeli

Shpenzime për personelin	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Paga dhe shpërblime	16,547,690	13,509,304
Sigurime Shoqërore	1,744,203	1,520,766
Pension Vullnetar	360,000	276,750
Sigurim jete shëndeti	197,432	155,161
Total	18,849,325	15,461,981

18.Shpenzime të tjera të veprimtarisë

	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Shërbime mirembajtje sistemi	2,022,208	2,098,163
Asistance nga palë të treta	738,700	604,347
Shërbime profesionale	489,100	705,820
Shpenzime noteriale dhe ligjore	-	5,040
Kancelari	223,272	136,800
Shpenzime postare dhe telefonike	169,885	141,549
Tarifë për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare FP	235,471	131,592
Tarifë për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare FI	535,942	284,006
Tarifa për Këshillin Mbikëqyrës	150,000	150,000
Komisione bankare	103,379	72,459
Taksa vendore dhe tarifa regjistrimi	360,700	98,100
Printime	52,170	62,170
Udhëtime, dieta	23,790	83,500
Shpenzime marketingu dhe design	102,917	-
Shpenzime pritje, uji	208,960	60,692
Shpenzime feste dhe të tjera	315,523	201,816
Total	5,732,017	4,836,054

19.Të ardhurat financiare

Të ardhura financiare	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Depozita	921,165	450,803
Llogari rrjedhëse	7,716	2,862
Të ardhura nga kuponi obligacionit	-	743,845
Total	928,881	1,197,510

20. Ngjarje pas dates së raportimit

Me shkresën tonë Nr.8 Prot datë 08.01.2019, është dërguar në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare për miratim ndryshimi i Nenit 5 të Statutit të Shoqërisë Credins Invest, ku janë pasqyruar ndryshimet e strukturës aksionare të Shoqërisë.

20. Ngjarje pas dates së raportimit (vazhdim)

Sipas Vendimit Nr. 3, Datë 26.12.2018 të Asamblesë së Aksionarëve të Shoqërisë Credins Invest u miratua ndryshimi i nenit 5 të Statutit “Kapitali i Shoqërisë”. Ndryshimet konsistojnë në pjesëmarrjen aksionare të SiCRED sh.a. dhe aksionarët e rinj të Shoqërisë, respektivisht SiCRED sh.a. bëhet zotërues në 12.00 % të paketës aksionare, Znj. Estela KOCI bëhet zotërues në 5 %, të paketës aksionare, Z. Egi Santo bëhet zotërues në 3.5 % të paketës aksionare, Z. Genc Koxhaj bëhet zotërues në 3.5 % të paketës aksionare të Shoqërisë “Credins Invest” sh.a. Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive

Ky miratim dhe regjistrimi në QKB do ta ndryshojë strukturën aksionare të shoqërisë si me poshtë:

	31 Dhjetor 2018			Kapitali pas regjistrimit te shitjes aksioneve		
	Në %	Numër aksionesh	Në Lek	Në %	Numër aksionesh	Në Lek
CREDINS Bank	76%	177,622	72,825,019	76%	177,622.00	72,825,019
SiCRED Sh.a.	24%	56,091.17	22,997,375	12%	28,045.58	11,498,687
Estela Koçi	-	-	-	5%	11,685.66	4,791,120
Genc Koxhaj	-	-	-	3,5%	8,179.96	3,353,784
Egi Santo	-	-	-	3,5%	8,179.96	3,353,784
	100	233,713.17	95,822,394	100	233,713.17	95,822,394

Nuk ka ngjarje pas datës së bilancit që mund të kërkojë korigjim ose shënime shtesë në pasqyrat financiare të shoqërisë.

Përgatiti

Armira CITOZI
Drejtoresh e Finances dhe Kontabilitetit

Miratoi

Estela KOCI
Administratore e Përgjithshme